

**OTP BANK ALBANIA SH.A.**

**Raporti i audituesit të pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare në datën dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

# Përmbajtja

Raporti i Audituesit të pavarur .....	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit.....	Error! Bookmark not defined.
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.....	Error! Bookmark not defined.
1. Të përgjithshme .....	5
2. Politika të rëndësishme kontabël .....	5-23
3. Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara .....	24-26
4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	27-28
5. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.....	28
6. Shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore .....	29
7. Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare.....	29
8. Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse .....	29-32
9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto .....	32-38
10. Aktive afatgjata materiale, neto .....	39
11. Aktive me të drejtë përdorimi, neto.....	Error! Bookmark not defined.
12. Aktive afatgjata jomateriale, neto.....	41
13. Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore .....	40-41
14. Aktivitet e tjera .....	42
15. Detyrime ndaj institucioneve financiare.....	41
16. Detyrime ndaj klientëve .....	42-43
17. Detyrime të qirasë.....	43-44
18. Detyrime të tjera.....	44
19. Provizione.....	44-45
20. Detyrime/(Aktive) tatimore të shtyra, neto .....	45-46
21. Kapitali aksionar .....	46
22. Rezerva .....	46-47
23. Të ardhura nga interesi.....	47
24. Shpenzime për interesa .....	47
25. Të ardhura nga komisionet.....	47
26. Shpenzime për komisionet .....	47
27. Humbjet kreditore për aktivet financiare .....	48
28. Çvlerësimi i aktiveve jo financiare.....	48
29. Shpenzime personeli.....	48
30. Shpenzime të përgjithshme administrative.....	49
31. Tatimi mbi fitimin .....	49-50
32. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara .....	52-51
33. Transaksionet me palët e lidhura.....	51-52
34. Ngjarjet pas datës së raportimit.....	52
35. Analiza e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve .....	53
36. Adminstrimi i rrezikut financiar.....	54-87

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Aksionarëve dhe Drejtimit të OTP Bank Albania Sha,

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OTP Bank Albania SHA. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### Theksimi çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin shpjegues nr. 34 të pasqyrave financiare që përshkruan vlerësimin e drejtimit mbi ndikimin aktual apo të mundshëm si pasojë e koronavirusit Covid-19 për Bankën. Opinioni ynë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

#### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditues tjetër i cili në datën 26 prill 2019, ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare.

#### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Bankës në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

## **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania SHPK*

Deloitte Audit Albania SHPK

Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7, 1010,

Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara  
*Partner Angazhimi*  
*Auditues ligjor*



**DELOITTE AUDIT ALBANIA**  
Ad. Rr. "Faik Konica", Ndërtesa Nr. 6, Hyrja Nr. 7, 1010 Tiranë  
TIRANA - ALBANIA  
NIPT: L 41709002 H  
Tel: 0445 17920

8 prill 2020  
Tiranë, Shqipëri

**OTP BANK ALBANIA SH.A.***(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)***Pasqyra e pozicionit financiar**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
<b>Aktivët</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5	5,060,808	6,546,978
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	6	6,645,062	6,592,887
Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare	7	1,629,697	1,460,558
Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	8	22,448,698	18,996,325
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	9	51,839,692	46,340,206
Qiratë financiare të arkëtueshme	9.2	1,178,855	1,129,951
Aktive afatgjata materiale, neto	10	488,128	312,515
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	11	542,976	-
Aktive afatgjata jomateriale, neto	12	205,955	235,805
Aktive tatimore të shtyra, neto	20	-	46,848
Aktive të marra në pronësi nga çështje gjyqësore	13	122,110	171,143
Aktive të tjera	14	485,388	343,867
<b>Totali i aktiveve</b>		<b><u>90,647,369</u></b>	<b><u>82,177,083</u></b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	13,595,144	6,747,335
Detyrime ndaj klientëve	16	66,345,074	67,353,709
Detyrime të qirasë	17	549,217	-
Detyrime tatimore të shtyra, neto	20	207,602	-
Detyrime të tjera	18	743,050	778,884
Provizione	19	122,231	121,585
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>81,562,318</u></b>	<b><u>75,001,513</u></b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	21	6,740,900	6,740,900
Primi i lidhur me aksionin		1,750	1,750
Rezerva	22	2,401,298	1,255,835
Humbje e akumuluar		(58,897)	(822,915)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b><u>9,085,051</u></b>	<b><u>7,175,570</u></b>
<b>Totali detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b><u>90,647,369</u></b>	<b><u>82,177,083</u></b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 87, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)

### Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	23	3,765,625	3,415,176
Shpenzime për interesat	24	(369,065)	(326,953)
<b>Marzhi neto nga interesat dhe të ardhurat e ngjashme</b>		<b>3,396,560</b>	<b>3,088,223</b>
Humbjet kreditore për aktivet financiare	27	(379,540)	(1,865,581)
<b>Marzhi neto nga interesat dhe të ardhurat e ngjashme pas humbjeve kreditore</b>		<b>3,017,020</b>	<b>1,222,642</b>
Të ardhura nga komisionet	25	661,751	592,965
Shpenzime nga komisionet	26	(180,157)	(132,560)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>481,594</b>	<b>460,405</b>
Fitimi nga kurset e këmbimit		156,899	181,232
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(4,376)	(107)
Humbje të tjera, neto		61	(3,524)
Humbje nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore		(22,520)	(53,697)
		<b>130,064</b>	<b>123,904</b>
Çvlerësimi i aktiveve të tjera	28	(19,633)	(256,309)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	10	(63,359)	(61,609)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	12	(70,029)	(62,605)
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	11	(121,285)	-
Shpenzime personeli	29	(827,634)	(884,385)
Shpenzime të përgjithshme administrative	30	(973,278)	(1,142,146)
		<b>(2,075,218)</b>	<b>(2,406,514)</b>
Shpenzime të tjera jo operative		(354,811)	-
<b>Fitimi / (Humbja) para tatimit</b>		<b>1,198,649</b>	<b>(599,563)</b>
Tatim fitimi aktual	31	(262,494)	(10)
Tatim fitimi i shtyrë	31	(9,748)	41,042
<b>Fitimi / (Humbja) e vitit, neto</b>		<b>926,407</b>	<b>(558,531)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në humbje ose fitim në periudhat e ardhshme</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		970,563	(322,164)
<b>Të ardhura / (shpenzime) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi</b>		<b>970,563</b>	<b>(322,164)</b>
<b>Totali i të ardhurave/ (humbjeve) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi</b>		<b>1,896,970</b>	<b>(880,695)</b>

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 87, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)

### Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullatore	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Teprica e raportuar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>596,180</b>	<b>462,565</b>	<b>1,174,727</b>	<b>8,976,122</b>
Ndikimi i zbatimit të SNRF 9- investime në letra me vlerë me VDATGj, neto nga aktivet tatimore të shtyra	-	-	-	35,465	(35,465)	-
Ndikimi i zbatimit të SNRF9- aktive të tjera Financiare, neto nga aktivet tatimore të shtyra	-	-	-	-	(400,288)	(400,288)
<b>Teprica më 1 janar 2018</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>596,180</b>	<b>498,030</b>	<b>738,974</b>	<b>8,575,834</b>
Humbja e vitit	-	-	-	-	(558,531)	(558,531)
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>						
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj	-	-	-	(322,164)	-	(322,164)
<b>Totali i shpenzimeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(322,164)</b>	<b>(558,531)</b>	<b>(880,695)</b>
Dividendë të deklaruar	-	-	-	-	(519,569)	(519,569)
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (shiko Shënimin 22 (ii))	-	-	483,789	-	(483,789)	-
<b>Teprica më 31 dhjetor 2018</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>1,079,969</b>	<b>175,866</b>	<b>(822,915)</b>	<b>7,175,570</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	926,407	926,407
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>						
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	1,091,245	-	1,091,245
Detyrime nga tatimi i shtyrë nga vlera e drejtë e aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	(167,804)	-	(167,804)
Rregullime nga viti i mëparshëm për detyrimin tatimor të shtyrë për vlerën e drejtë të letrave me vlerë me VDATGj (shiko Shënimin 20)	-	-	-	47,122	-	47,122
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>970,563</b>	<b>926,407</b>	<b>1,896,970</b>
Çregjistrim i aktivitetit tatimor të shtyrë nga zbatimi fillestar i SNRF 9	-	-	-	-	(76,898)	(76,898)
Rregullime nga viti i mëparshëm për detyrimin në tatimin e shtyrë për vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj (shiko Shënimin 20)	-	-	-	-	(47,122)	(47,122)
Fondi për zhvlerësimin e aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	136,531	-	136,531
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (shiko Shënimin 22 (ii))	-	-	38,369	-	(38,369)	-
<b>Teprica më 31 dhjetor 2019</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>1,118,338</b>	<b>1,282,960</b>	<b>(58,897)</b>	<b>9,085,051</b>

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 87, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare



**OTP BANK ALBANIA SH.A.**

**Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2019**

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

**Pasqyra e flukseve monetare**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor	
	2019	2018
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga operacionet:</b>		
<b>Fitimi/(Humbja) para tatimit</b>	<b>1,198,649</b>	<b>(599,563)</b>
<i>Rregullime për të kuadruar rezultatin neto me rrjedhjen neto të flukseve monetare nga veprimtaritë operative:</i>		
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	12 63,359	61,609
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	13 70,029	62,065
Zhvlerësimi i aktiveve financiare	27 378,927	1,828,675
Çvlerësime mbi aktivet e marra në rrugë ligjore	19,633	240,521
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	4,376	107
Humbje nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore	22,520	53,697
Të ardhura nga interesat	23 (3,765,625)	(3,415,176)
Efekt nga ndryshimi i kursit të këmbimit	46,215	379,451
Shpenzime nga interesat	24 369,065	326,953
Çvlerësim i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	-	11,544
<b>Rrjedha e mjeteve monetare nga fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>	<b>(1,592,851)</b>	<b>(1,050,117)</b>
<i>Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:</i>		
Rritja në shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	(52,343)	(243,494)
Rritje në huatë dhënë institucioneve financiare	(176,696)	(93,037)
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(5,808,059)	(1,028,508)
Rritje në aktive të tjera	(35,834)	(72,392)
Rritje në detyrimet ndaj institucioneve financiare	6,847,881	3,122,747
Pakësim në detyrimet ndaj klientëve	(1,029,448)	(867,971)
(Pakësim)/rritje në detyrime të tjera	(118,580)	257,980
Pakësim në detyrime të lidhura me aktive të mbajtura për shitje	-	(26,458)
Interesi i arkëtuar	3,767,692	3,437,291
Interesi i paguar	(348,326)	(300,912)
Tatim fitimi i paguar	(282,423)	(153,164)
<b>Fluksi neto i mjeteve monetare gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>1,171,011</b>	<b>2,981,965</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese:</b>		
Blerje e aktiveve financiare me VDATGj	(7,715,557)	(2,960,855)
Të hyra nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe riblerjet e letrave me vlerë të borxhit të mbajtura me VDATGj	5,326,853	3,399,616
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(38,767)	(67,163)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(235,703)	(62,924)
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	5,992	1,490
<b>Fluksi neto i mjeteve monetare (përdorur për)/gjeneruar nga veprimtaritë investuese</b>	<b>(2,657,182)</b>	<b>310,164</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese:</b>		
Pagesa e dividendit	-	(519,569)
<b>Fluksi neto i mjeteve monetare përdorur për veprimtaritë financuese</b>	<b>-</b>	<b>(519,569)</b>
<b>(Rënie)/rritje neto në mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>(1,486,170)</b>	<b>2,772,560</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit</b>	<b>6,546,978</b>	<b>3,774,418</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>5,060,808</b>	<b>6,546,978</b>

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 87, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 19 mars 2020 dhe janë firmosur nga:

**Bledar Shella**  
Drejtor i Përgjithshëm



**Gabor Jandacsik**  
Drejtor i Financës & Riskut

# OTP BANK ALBANIA SH.A.

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)

### 1. Të përgjithshme

Banka OTP Albania Sh.a, e njohur më parë si Societe General Albania, ("Banka") është një institucion financiar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe u liçencua nga Banka e Shqipërisë më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 "Mbi sistemin bankar në Shqipëri", i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë". Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004.

Bazuar në marrëveshjen e blerjes së aksioneve të datës 28 mars 2019, OTP Bank NYRT bleu 100% te aksioneve te Societe Generale Albania sh.a. nga aksioneri i meparshem Societe Generale Group me vendndodhje ne Francë (shiko Shënimin 21).

Më 31 dhjetor 2019, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 37 degëve të saj (2018: 35 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2019 Banka kishte 454 punonjës (31 dhjetor 2018: 423 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është pranë Tëin Toëers, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2019, Këshilli Mbikqyrës dhe Komiteti i Kontrollit të Bankës përbëhet nga anetarët e mëposhtëm:

<b>Këshilli Mbikqyrës</b>	Peter Janos Bese	Kryetar
	Janos Veres	Anëtar
	Arpad Sranko	Anëtar
	Tunde Soos	Anëtar
	Aleksandër Xhuvani	Anëtar
	Adrian Civici	Anëtar
	Armando Duka	Anëtar
<b>Komiteti i Kontrollit</b>	Arpad Sranko	Kryetare
	Jitka Pantuckova	Anëtare
	Diana Ylli	Anëtare

### 2. Politika të rëndësishme kontabël

Banka ka zbatuar në mënyrë konsistente politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e prezantuar në këto pasqyra financiare, përvec standardit të ri, SNRF 16 Qiratë, i cili është implementuar më 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, nëpërmjet të cilës tepricat celëse më 1 janar 2019 janë riparaqitur.

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Keto jane pasqyrat e para financiare në të cilat është zbatuar SNRF 16 Qiratë. Ndryshimet përkatëse te politikave kontabël janë detajuar në Shënimin 3.

#### (b) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjerë gjithëpërfshirëse, të cilat maten me vlerën e drejtë.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqiptar "Lek", e cila është monedha funksionale e Bankës.

#### (d) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit për aktivet monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

---

## **2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(e) Interesi**

#### ***Metoda e normës efektive së interesit***

Të ardhurat nga interesi regjistrohen duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) për të gjitha instrumentet financiare të matura me koston e amortizuar. Të ardhurat nga interesi nga instrumentat e borxhit të mbajtur me VDATGj gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën NEI. NEI është norma që pikërisht aktualizon flukset e ardhshme të parave përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto të aktivitetit financiar. Norma efektive e interesit (dhe për këtë arsye, kostoja e amortizuar e aktivitetit) llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim për blerjen, tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e NEI. Banka njeh të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, Banka njeh efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme të ngarkuara në faza të ndryshme dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (përfshirë parapagimet, interesat e penaliteteve dhe gjobat).

Nëse parashikimet për flukset e mjeteve monetare të aktivitetit financiar rishikohen për arsye të ndryshme nga rreziku i kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv ose negativ i vlerës kontabël të aktivitetit në bilanc me një rritje ose ulje të të ardhurave nga interesi. Rregullimi më pas amortizohet nëpërmjet të ardhurave nga interesi në pasqyrën e të ardhurave

#### ***Interesa dhe të ardhura të ngjashme***

Të ardhurat nga veprimtaritë bankare, duke përfshirë të ardhurat nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve, të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, njihen në fitim ose humbje duke zbatuar NIE në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç aktiveve të zhvlerësuar.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Faza 3' (shiko Shënimin 3 (k) (iv) A), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar NIE në koston e amortizuar neto të aktivitetit financiar. Nëse mjetet financiare trajtohen dhe nuk kanë zhvlerësim, Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto. Për aktivet financiare të zhvlerësuar që në blerje ose në krijim (POCI), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të rregulluar dhe duke zbatuar atë normë në koston e amortizuar të aktivitetit. Norma Efektive e Interesit e rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, aktualizon flukset monetare të ardhshme të vlerësuar (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të aktiveve të zhvlerësuar që në blerje ose në krijim (POCI).

### **(e) Tarifa dhe komisione**

Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat mund të ndahen në tre kategoritë e mëposhtme:

#### **A. Të ardhurat nga tarifat e fituara nga shërbimet që ofrohen gjatë një periudhe të caktuar kohore.**

Tarifat dhe komisionet e fituara nga ofrimi i shërbimeve gjatë një periudhe kohore janë grumbulluar gjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhurat nga komisionet, duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e menaxhimit të investimeve dhe tarifat e vendosjes.

#### **B. Të ardhurat nga tarifat nga ofrimi i shërbimeve financiare dhe të fituara për ekzekutimin e një akti të rëndësishëm**

Tarifat dhe komisionet që dalin nga negocimi ose pjesëmarrja në negocimin e një transaksioni me një palë të tretë, siç janë tarifat e tjera dhe shpenzimet e komisioneve që lidhen kryesisht me tarifat e transaksionit dhe shërbimit, njihen pas përfundimit të transaksionit bazë. Tarifat ose komponentët e tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas plotësimit të kriterëve përkatëse.

#### **C. Të ardhurat nga tarifat që përbëjnë një pjesë integrale të instrumentit financiar korrespondues**

Tarifat që Banka konsideron të jenë pjesë përbërëse e instrumenteve financiare përkatëse përfshijnë: tarifat e origjinës së huasë, pagesat e angazhimit të kredisë për huatë që ka gjasa të tërhiqen dhe tarifat e tjera të lidhura me kredinë. Njohja e këtyre tarifave (së bashku me kostot shtesë) përbëjnë një pjesë integrale të instrumenteve financiare përkatëse dhe njihen si të ardhura nga interesi nëpërmjet një rregullimi në NIE. Përfshirë është, kur nuk ka gjasa që një kredi të tërhiqet, tarifat e angazhimit të huasë njihen si të ardhura me skadim. Detyrimet e huasë që janë në kuadër të fushëveprimit të SNRF 9 (dmth., janë përcaktuar me VDPFH ose janë nën një normë interesi të tregut, ose janë përcaktuar neto) llogariten si derivativë dhe maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

---

## **2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(f) Qiraja**

*Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019*

Në lidhjen e një kontrate, Banka përcakton nëse kontrata është ose përmban një kontratë qiraje. Një kontratë është ose përmban një kontratë qiraje, nëse jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohore të përcaktuar në këmbim të pagesës së një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë e caktuar i jep të drejtën për të përdorur një aktiv të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16. Kjo politikë është zbatuar mbi kontratat e lidhura (ose ndyshuara) në dhe pas datës 1 janar 2019.

#### **i. Banka si qiramarrëse**

Si qiramarrës, Banka merr me qira disa ambiente për zyra dhe degë, pasuri të patundshme dhe pajisje informatike. Në momentin e lidhjes apo modifikimit të një kontrate që përmban një qira, Banka përcakton shumën në kontratë të ndarë për secilin përbërës së qirasë mbi bazën e çmimit relativ përkatës të tij. Sidoqoftë, për qiratë e ndërtesave, Banka ka vendosur që të kombinojë përbërësit jo-qira me përbërësit qira dhe t'i trajtojë ato si një përbërës i vetëm i qirasë.

Banka njeh një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim për qiranë në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet fillimisht me koston e tij, që përmban shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar me çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, plus çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin për çmontimin dhe lëvizjen e aktivitet bazë, restaurimin e aktivitet apo vendit në të cilin është vendosur aktivi, minus çdo stimul qiraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet nëpërmjet metodës lineare nga dita e fillimit të qirasë deri në fund të afatit të qirasë. Gjithashtu, vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi ulet periodikisht me humbjen nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet me vlerën e ndonjë ri-matjeje të caktuara për detyrimin e qirasë. Detyrimi për qiranë njihet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar ende në atë datë, të skontuara me normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, do të përdoret norma rritëse e huamarrjes e Bankës. Përgjithësisht, Banka përdor normën rritëse të huamarrjes për të skontuar pagesat e qirasë.

Banka përcakton normën rritëse të huamarrjes duke marrë norma interesi nga burime të ndryshme të jashtme financimi dhe duke bërë rregullime të ndryshme për të reflektuar termat e qirasë dhe llojin e aktivitet të marrë me qira. Pagesat e qirasë që përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga elementët më poshtë:

- pagesat fikse, duke përfshirë këtu dhe pagesat fikse në-thelb,
- pagesat variabël të qirasë, të cilat varen nga një indeks ose normë, që maten fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Banka ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, pagesat e qirasë për një periudhë rinovimi opsionale nëse Banka ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin e zgjatjes së afatit të qirasë dhe pagesat e gjobave për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Banka ka siguri të arsyeshme që nuk do të përfundojë kontratën para kohe.

Detyrimi për qiranë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Detyrimi rivlerësohet kur ka ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë, të cilat vijnë nga ndryshimi në një indeks ose normë, kur ka ndryshim në vlerësimet e Bankës mbi shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë, nëse Banka ndryshon përcaktimin e saj për të ushtruar një opsion blerjeje. zgjatje të afatit apo një opsion të përfundimit të qirasë ose nëse ka ndonjë rishikim në pagesat fikse në-thelb të qirasë. Kur detyrimi për qiranë rimatet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël neto të aktivitet me të drejtë përdorimi ose regjistrohet ndryshimi në fitim ose humbje e vitit nëse vlera e aktivitet me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

#### **Përcaktimi i afatit të qirasë**

Disa qira të ambjenteve të zyrave përmbajnë opsione zgjatjeje të ekzekutueshme nga Banka deri në një vit para fundit të peridhës të paanullueshme kontraktore. Kur është e mundur, Banka kërkon të përfshijë opsionet e zgjatjes në qira të reja për të siguruar fleksibilitet operacional. Banka vlerëson në datën e fillimit të qirasë nëse është me siguri të arsyeshme ushtrimi i opsioneve të zgjatjes. Banka vlerëson nëse ekziston siguri e arsyeshme për të ushtruar opsionet nëse ka ngjarje të rëndësishme apo ndryshime të rëndësishme të rrethanave jashtë kontrollit të Bankës.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

---

## **2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(g) Qiraja (vazhdim)**

*Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019 (vazhdim)*

#### **Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët**

Banka ka vendosur të mos njohë aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime për qira për qiratë me vlerë të ulët të aktivitetit dhe qiratë afatshkurtra, duke përfshirë pajisjet informatike. Shoqëria njeh pagesat e qirasë për këto qira si shpenzim mbi bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

#### **ii. Banka si qiradhënëse**

Qiratë në të cilat Banka transferon kryesisht të gjithë rrezikun dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e pozicionit financiar Banka paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën e investimit neto. Njohja e të ardhurave financiare duhet të bazohet në një model që pasqyron një normë periodike konstante të kthimit të investimit neto të qiradhënësit në qiranë financiare. Pagesat e qirasë në lidhje me periudhën, duke përjashtuar kostot për shërbime, zbatohen kundrejt investimit bruto në qira, për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurat financiare të paarkëtuara.

*Politika e zbatueshme para 1 janarit 2019*

#### **Banka si qiramarrëse - Pagesat operative të qirasë**

Përcaktimi nëse një marrëveshje është një kontratë qiraje ose përmban një kontratë qiraje, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi të caktuar ose aktiveve dhe marrëveshja përcjell të drejtën për të përdorur aktivin. Qiratë, që në thelb, nuk transferojnë në Bankë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e sendeve të dhëna me qira janë qiratë operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në baza lineare gjatë periudhës së qirasë. Incentivat e qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

#### **Banka si qiradhënëse**

Politika kontabël nuk ka ndryshuar me zbatimin e SNRF 16. Referohu më sipër në seksionin *Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019*

### **(h) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

#### **(i) Përfitimet e punonjësve**

*(i). Plani i përcaktuar i kontributeve*

Detyrimet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

*(ii). Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të paskontuara dhe njihen si shpenzime pasi ofrohet shërbimi i lidhur. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet nën bonusin afatshkurtër të parave ose planet e ndarjes së fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të mëparshme të ofruar nga punëmarrësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme

*(iii). Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve*

Detyrimi neto i Bankës në lidhje me përfitimet afatgjata të punonjësve është shuma e përfitimit të ardhshëm që punonjësit kanë fituar në këmbim të shërbimit të tyre në periudhat aktuale dhe të mëparshme. Ky përfitim skontohehet për të përcaktuar vlerën e tij aktuale. Rivlerësimet njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato lindin.

*(iv). Benefitet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit*

Benefitet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit njihen si shpenzime në kohën me të hershme kur Banka nuk mund të tërheqë më ofertën e këtyre përfitimeve dhe kur Banka njeh kostot për një ristrukturim. Nëse përfitimet nuk pritet të shlyhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohehen.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

---

**2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****(i) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)**

(iv). Benefitet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit (vazhdim)

Vlera e drejtë e shumës së pagueshme për punonjësit, të cilat shlyhen në para, njihet si shpenzim me një rritje korresponduese të detyrimeve, për periudhën gjatë së cilës punonjësit kanë të drejtën e marrjes së pagesës. Detyrimi rivlerësohet në çdo datë raportimi dhe në datën e shlyerjes. Cdo ndryshim në detyrim njihet si shpenzime të personelit në fitim ose humbje.

**(j) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

**(i) Tatimi aktual**

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshme ose të arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet që pasqyron pasigurinë në lidhje me taksat e të ardhurave, nëse ka. Ajo matet duke përdorur tarifatat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Aktivi dhe detyrimi tatimor aktual mund të kompesojnë njëra tjetrën vetëm nëse kriteret specifike plotësohen.

**(ii) Tatimi i shtyrë**

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e pozicionit financiar, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar, dhe bazës së tyre tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë në datën e raportimit. Detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjithë diferencat e përkohshme të tatueshme. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet. Tatime të tjera mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët

**(k) Instrumentet financiarë****(i) Njohja fillestare dhe matja e mëpasshme*****Data e njohjes***

Aktivet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të huave dhe paradhënies për klientët dhe tepricat për shkak të klientëve, fillimisht njihen në datën e tregtimit, dmth. Data kur Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin tregtimet e rregullta të mënyrave: blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënie të aktiveve brenda afatit kohor të përcaktuar përgjithësisht me rregullore ose konventë në treg. Huatë dhe paradhëniet për klientët njihen kur fondet transferohen në llogaritë të klientëve. Banka njihet bilancet për klientët kur fondet transferohen në Bankë.

***Matja fillestare e instrumenteve financiare***

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe nga modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve, siç përshkruhet në Shënimet 3 (k) (i) (testimi i modelit të biznesit dhe testimi i VPPI). Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë (siç përcaktohet në Shënimin 3 (k)), përveç në rastin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në VDPFH, kostot e transaksionit shtohen ose zbriten nga kjo shumë. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka llogarit fitimin ose humbjen e Ditës 1, siç përshkruhet më poshtë.

***Fitimi ose humbja e Ditës 1***

Kur çmimi i transaksionit të instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë në krijimin e tij dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njihet dallimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregtimit.

*(të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)*

---

**2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(k) Instrumentet financiarë (vazhdim)**

**(i) Njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

***Fitimi ose humbja e Ditës 1 (vazhdim)***

Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë zhvlerësohet dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

***Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare***

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivitetit, të matura me:

- Kosto të amortizuar, siç shpjegohet në Shënimin 3 (k) (i) A
- VDATGj, siç shpjegohet në Shënimin 3 (k) (i) C
- VDPFH, siç shpjegohet në Shënimin 3 (k) (i) D

Banka klasifikon dhe mat portofolin e saj të tregtimit me VDPFH. Banka mund të caktojë instrumenta financiarë në VDPFH, nëse kështu eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes, siç shpjegohet në Shënimin 3 (k) (i) D. Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të kredive dhe garancive financiare, maten me metodën e koston së amortizuar ose VDPFH, në rastet që mbahen për tregtim dhe si instrumenta derivativë ose përcaktimi i vlerës së drejtë, siç shpjegohet në 3 (k) (i) D.

**(ii) Klasifikimi**

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me metodën e koston së amortizuar, VDATGj ose VDPFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk zbatohet VDPFH:

- Aktiv i financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes për të mbledhur flukse monetare kontraktuale të aktivitetit
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin flukset e mjeteve monetare në datat e përcaktuara të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)

Një aktiv financiar matet me VDATGj vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk zbatohet VDPFH:

- Aktiv i financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes për të mbledhur flukse monetare kontraktuale të aktivitetit dhe shitjes së tij
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin flukset e mjeteve monetare në datat e përcaktuara të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)

**Vlerësimi i modelit të biznesit**

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet për cdo instrument, por në një nivel më të lartë të portofoleve të grumbulluara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Si vlerësohen dhe raportohen performanca e modelit të biznesit dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi të personelit drejtues të njësisë ekonomike
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura në atë model biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato rreziqe
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura)
- Shpeshtësia e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Bankës.

